



## URDHRI I STOMATOLOGUT TË SHQPËRISË KËSHILLI KOMBËTAR

Tiranë, më 19.12.2025

### RREGULLORE PËR GJYKIMIN PROFESIONAL DISIPLINOR NË USSH

#### KREU I PARIME TË PËRGJITHSHME

##### Neni 1 Objekti, qëllimi dhe baza ligjore

1. Objekt i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregulla të detajuara për zhvillimin gjykimave dhe procedurave disiplinore të Urdhrit të Stomatologëve të Shqipërisë për shqyrtimin e çështjeve disiplinore të zhvilluara ndaj stomatologëve, ndihmëstomatologëve drejtuesve teknikë dhe anëtarëve të tjerë të USSH-së Teknikë dentarë, teknikë e lartë dentar, higjenist dentar, asistent dentar të pajisur me liçensë individuale të ushtrimit të profesionit dhe që ushtrojnë profesionin në Republikën e Shqipërisë.
2. Procedura disiplinore garanton ushtrimin e profesionit të stomatologut, drejtuesit teknik, ndihmës stomatologut, Teknikëve dentarë, teknikë e lartë dentar, higjenist dentar, asistent dentar në mbrojtje të të drejtave të tyre, të pacientit, si dhe çdo subjekti tjetër që lidhet me këtë profesion. Zhvillimi i gjykimit disiplinor/procedurës disiplinore garantohehet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (parimi i procesit të rregullt ligjor), ligji nr. 127/2014 “Për Urdhrit e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë”, Statutit të Urdhrit të Stomatologut të Shqipërisë, Kodit të Procedurave Administrative, si dhe kësaj rregulloreje.
3. Qëllimi i gjykimit dhe procedurës disiplinore është garantimi dhe ruajtja e standardeve për ushtrimin individual të profesionit të stomatologut, drejtuesit teknik, ndihmëstomatologut Teknikë dentarë, teknikë e lartë dentar, higjenist dentar, asistent dentar dhe marrjen e masave disiplinore ndaj tyre, anëtarë të Urdhrit të Stomatologut të Shqipërisë, që shkelin dispozitat e ligjit nr. 127/2014 “Për Urdhrit e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë”, Statutit të Urdhrit të Stomatologut të Shqipërisë, Kodit Etik Deontologjik gjatë ushtrimit të profesionit të tyre.

## Neni 2

### Parimet e procedurës dhe gjykimit disiplinor

1. Përveç bazës ligjore të përmendur më sipër, Urdhri i Stomatologut të Shqipërisë, në ushtrimin e funksioneve të tij gjatë procedurës dhe gjykimit disiplinor bazohet në parimet si më poshtë:
  - a) E Drejta për një proces të rregullt ligjor, duke përfshirë të drejtat e palëve për të paraqitur prova, për tu dëgjuar, për tu përfaqësuar nga një mbrojtës, si dhe marrjen e një vendimi brenda një afati të arsyeshëm.
  - b) Parimin e ligjshmërisë, i cili parashikon se USSH ushtron veprimtarinë e saj në bazë të legjislacionit në fuqi në kohën e kryerjes së shkeljes së prezumuar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 127/2014 “Për Urdhrit e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë”, Statutit të Urdhrit të Stomatologut të Shqipërisë, Kodit të Procedurave Administrative, si dhe kësaj rregulloreje brenda kufijve të kompetencave të saj dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca.
  - c) Parimin e transparencës, cili parashikon se USSH ushtron veprimtarinë e saj administrative në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në të.
  - d) Parimin e informimit, ruajtjes dhe mbrojtjes së konfidencialitetit, të cilët përfshijnë të drejtën e çdo subjekti për të kërkuar informacion publik, që ka të bëjë me veprimtarinë e organit publik, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon të drejtën e informimit dhe në të njëjtën kohë detyrimin e organit publik (USSH) për të mbrojtur të dhënat personale dhe konfidenciale të të gjithë subjekteve që marrin pjesë në një gjykim disiplinor.
  - e) Parimi i drejtësisë, paanësisë dhe objektivitetit, i cili parashikon se në ushtrimin e funksioneve të saj USSH trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjektet me të cilat krijon marrëdhënie. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, USSH merr në konsideratë dhe i jep rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative.
2. Gjithashtu, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, USSH dhe Komisionet Disiplinore respektojnë parimin e barazisë përpara ligjit, parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin e proporcionalitetit, të drejtën për të bërë ankim, si dhe çdo të drejtë që i garantohet subjekteve të së drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe legjislacionit në fuqi.
3. USSH dhe Komisionet Disiplinore fillojnë procedurën disiplinore vetëm për çështje që janë në kompetencë të saj, mbi bazën e ankimeve/kërkesave të arsyetuara, që kanë elementët e përcaktar në Kodin e Procedurës Administrative, të bazuara në prova.
4. Nëse USSH, apo urdhrat në rajonet përkatëse që kanë në kompetencë shqyrtimin e kërkesës/ankimit, konstatojnë se kërkesa është haptazi e pa bazuar dhe/ose e pambështetur në prova, vendosin për mospranimin e ankesës/kërkesës. Në këtë rast hartohet vendimi përkatës i arsyetuar, i cili i njoftohet palëve, të cilat rezervojnë të

drejtën e ankimit kundër aktit administrativ që nuk ka pranuar kërkesën/ankimin e tyre brenda afateve ligjore.

5. Kur konstatohet se stomatologu/klinika që ka reklamuar çmimet, ofertat dhe garancitë për produktin në çdo lloj mënyre brenda dhe jashtë vendit për arsye përfitimi, për klinikën që ushtron veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë, Sektori i Monitorimit paralajmëron stomatologun/klinikën me procesverbal konstatimi për të hequr menjëherë reklamimin e çmimeve, ofertave dhe garancitë për produktin. Në rastet kur reklamimi i çmimeve ofertave dhe garancitë nuk hiqet për 48 orë, Komisioni Disiplinor Rajonal merr masën disiplinore gjobë 100.000 (njëqind mijë) lekë pasi ka zhvilluar seancën dëgjimore sipas rregullave të përgjithshme. Masa disiplinore i njoftohet klinikës/stomatologut, i cili ka të drejtën e ankimit në Komisionin Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar.

### **Neni 3**

#### **Gjykimi dhe procedura disiplinore për shtetasit e huaj që ushtrojnë profesionin e stomatologut në Republikën e Shqipërisë**

1. Shtetasit e huaj që ushtrojnë profesionin e stomatologut në Republikën e Shqipërisë kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime si shtetasit shqiptarë që ushtrojnë këtë profesion. Për të ushtruar profesionin e stomatologut në Republikën e Shqipërisë, ata duhet të regjistrohen dhe të liçensohen nga Urdhri i Stomatologut të Shqipërisë sipas legjislacionit në fuqi. Shtetasit e huaj që ushtrojnë profesionin e stomatologut në Republikën e Shqipërisë, anëtarë të USSH, i nënshtrohen gjykimit dhe procedurës disiplinore në zbatim të ligjit nr. 127/2014 “Për Urdhrin e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë”, Statutit të Urdhrit të Stomatologut të Shqipërisë, Kodit të Procedurave Administrative, si dhe kësaj rregulloreje sikundër shtetasit shqiptarë, anëtarë të USSH.
2. Procedura dhe gjykimi disiplinor zhvillohet në gjuhën dhe shkrimin shqip. Shpenzimet për përkthyesin dhe përfaqësuesin ligjor mbulohen nga vetë shtetasit e huaj.
3. Masa disiplinore e vendosur ndaj tyre i njoftohet organit homolog, apo çdo organi tjetër që ka bërë liçensimin e tyre, ku këta shtetas ushtrojnë profesionin e stomatologut.

### **KREU II**

#### **FILLIMI I PROCEDURËS DISIPLINORE DHE GJYKIMI DISIPLINOR**

### **Neni 4**

1. Stomatologu dhe ndihmës stomatologu, anëtar i USSH që ushtron veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë i nënshtrohet gjykimit disiplinor për këto shkaqe:
  - a) Kur ndaj tij është paraqitur kërkesë/ankim për mjekim të pakujdesshëm, kur fakti nuk përbën vepër penale, ose për sjellje profesionale të padenjë.

- b) Kur stomatologu, ose ndihmës stomatologu është dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për vepra penale që kanë të bëjnë me ushtrimin e profesionit të stomatologut.
  - c) Kur për shkak të gjendjes shëndetësore bëhet i paafte, ose i papërgjegjshëm për të ushtruar profesionin e stomatologut. Paafësia ose papërgjegjshmëria vërtetohet me anë të aktit administrativ të lëshuar nga organi kompetent.
  - d) Kur refuzon të zbatojë ligjin nr. 127/2014 “Për Urdhrin e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë”, Statutin e Urdhrit të Stomatologut të Shqipërisë, këtë rregullore, urdhrat, udhëzimet, si dhe çdo akt tjetër administrativ të nxjerrë nga USSH, ose kur refuzon të paraqitet në USSH kur kjo kërkohet nga kjo e fundit për të dhënë shpjegime për çështje të ndryshme.
  - e) Kur stomatologu, drejtuesi teknik, ose subjekti që përfaqëson pronësinë e klinikës zhvillon reklamë në media, rrjete sociale, ose në portale brenda dhe jashtë vendit me çmime konkrete të tarifave, ofertave dhe garancitë për produktin, ose shërbimin dentar për klinikën që ushtron veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë.
  - f) Kur stomatologu, ose ndihmës stomatologu ushtron profesionin në kushtet kur i ka përfunduar afati i vlefshmërisë së licencës.
  - g) Kur stomatologu, anëtar i USSH nuk ka paguar kuotizacionin për një vit, ose një periudhë më të gjatë.
  - h) Kur kompetenca, ose performanca profesionale e stomatologut ka mangësi serioze, të cilat mund të dëmtojnë shëndetin e pacientit, ose dëmtojnë imazhin dhe figurën e stomatologut.
  - i) Kur stomatologu përdor grada shkencore, tituj akademikë, të cilat nuk i disponon, ose nuk i ka fituar.
2. Në rastet kur shkak, ose fakti për të cilin ka filluar procedura disiplinore i është referuar njëkohësisht edhe organit që ushtron ndjekjen penale, ose gjykatës, USSH, ose Komisionet disiplinore rajonale pezullojnë menjëherë procedurën disiplinore deri sa gjykata të marrë vendim të formës së prerë për çështjen konkrete që është referuar. Në këto raste USSH bashkëpunon me organet e drejtësisë duke vendosur në dispozicion të tyre çdo material shkresor në lidhje me çështjen, si dhe çdo dokumentacion tjetër që ka të bëjë me licënsimin, rilicënsimin, apo procedime të tjera disiplinore në ngarkim të stomatologut.

## **Neni 5**

### **Subjektet që mund të paraqesin ankesë**

1. Kërkesa/ankesa për fillimin e procedurës disiplinore ndaj një stomatologu, drejtuesi teknik, ose ndihmës stomatologu anëtar të USSH që ushtron profesionin në Republikën e Shqipërisë mund të paraqitet nga:
  - a) Pacienti ndaj të cilit është kryer mjekim i pakujdesshëm, ose i cili ka pësuar një sjellje profesionale të padenjë.
  - b) Ministria përgjegjëse për shëndetësinë në Republikën e Shqipërisë, ose institucione të tjera publike në Republikën e Shqipërisë.

- c) Çdo anëtar i USSH, i cili konstaton shkelje të ligjit nr. 127/2014 “Për Urdhrin e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë”, Statutit të Urdhrit të Stomatologut të Shqipërisë, Kodit Etik Deontologjik, si dhe kësaj rregulloreje.
  - d) Presidenti i Këshillit Kombëtar të USSH, ose Presidentët e Këshillave Rajonalë.
2. Procedura dhe gjykimi disiplinor fillon kryesish nga USSH, ose urdhrat rajonalë, kur njoftimi merret nga organet e medias audiovizive, ose të shkruar, ose në çdo mënyrë tjetër të parashikuar nga ligji.

## **Neni 6**

### **Forma e kërkesës dhe provat që duhet të paraqiten**

1. Ankesa/Kërkesa për fillimin e procedurës disiplinore paraqitet përpara Urdhrit Rajonal në të cilin stomatologu është anëtar. Kërkesa duhet të jetë në formë shkresore dhe duhet të tregojë në mënyrë të qartë identitetin e ankuesit, identitetin e stomatologut dhe/ose emrin e klinikës në të cilin është marrë trajtimi mjekësor, faktet dhe rrethanat e çështjes, të përcaktojë veprimin konkret, që pretendohet se përbën shkelje disiplinore dhe rrethanat e kryerjes së tij, provat në të cilin mbështeten pretendimet, çdo dokument apo provë tjetër në ndihmë të procedimit disiplinor, si dhe pagesën përkatëse për fillimin e gjykimit disiplinor në llogarinë bankare të USSH. Kërkesa duhet të jetë e firmosur nga ankuesi/kërkuesi dhe i bashkëngjitet karta e identitetit të ankuesit.
2. Në çdo rast USSH garanton mbrojtjen e të dhënave personale dhe/ose konfidenciale.
3. Në rast se kërkesa, paraqitet pranë USSH, kjo e fundit brenda dy ditëve punë e përcjell atë te Këshilli Rajonal që ka në kompetencë shqyrtimin e saj.
4. Këshillat Rajonalë dhe USSH në asnjë rast nuk pranojnë kërkesa që nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, ose kërkesa haptazi të pabazuara.
5. Në rastet kur procedura/gjykimi disiplinor fillon kryesish nga USSH, ose këshillat rajonalë, këto të fundit, ose organet disiplinore i drejtohen stomatologut për të paraqitur kartelën klinike dhe konsentin e pacientit të dëmtuar, si dhe çdo provë tjetër në dobi të procedurës dhe gjykimit disiplinor, si dhe përcaktojnë kohën e nevojshme për të përgatitur mbrojtjen.

## **Neni 7**

### **Organet në procedurën dhe gjykimin disiplinor**

1. Procedura dhe gjykimi disiplinor zhvillohet në dy shkallë:
  - a) Shkalla e parë, e cila zhvillohet në Komisionin Disiplinor pranë Këshillit Rajonal të USSH, i cili ka në juridiksion, klinikën apo stomatologun për të cilin është paraqitur ankesë.
  - b) Shkalla e dytë e cila zhvillohet në Komisionin Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar të USSH.
2. Komisioni Disiplinor Rajonal, përbëhet nga 7 anëtarë. Komisioni Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar përbëhet nga 9 anëtarë. Në çdo rast komisionet disiplinore asistohen nga një jurist, ose nëse kërkohet nga komisionet rajonale, nga njëسيا juridike

pranë USSH. Komisioni disiplinor pranë Këshillit Kombëtar të USSH asistohet gjithmonë nga njësia juridike pranë USSH. Prania e juristit në komision është kriter i domosdoshëm, por ai nuk ka të drejtën e votës në Komision.

3. Komisioni disiplinor rajonal dhe Komisioni Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar zhvillojnë mbledhjet me kolegje të përbëra nga tre anëtarë. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve. Në rastet kur një nga anëtarët voton kundër, ai duhet të arsyetojë me shkrim vendimin e tij, i cili i bashkëngjitet vendimit përfundimtar.
4. Në rastet kur një apo më shumë anëtarë të Komisionit Disiplinor janë në konflikt interesi me çështjen që po shqyrtohet, ata e deklarojnë konfliktin përpara se të fillojë çështja. Në ato raste kur konflikti ka lindur, ose është zbuluar gjatë shqyrtimit të çështjes, anëtari përjashtohet menjëherë nga Komisioni dhe zëvendosohet me një anëtar tjetër. Në çdo rast zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative.
5. Në rast se për zgjidhjen e një çështjeje të caktuar, kërkohen njohuri të posaçme/specializuara në fusha të ndryshme, Komisionet Disiplinore kërkojnë ndihmën e një eksperti të jashtëm në fushën përkatëse, i cili zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhjen e Komisionit Disiplinor.
6. Kolegjet disiplinore përcaktohen nga Kryetari i Komisionit Disiplinor, sipas specifikave/specialitetit të çështjes që do të gjykohej. Në përbërje të kolegjit është e detyrueshme prania e kryetarit, ose zv. Kryetarit të Komisionit Disiplinor. Në çdo rast, juristi është gjithmonë i pranishëm.
7. Për çështje që kanë të bëjnë me unifikimin e praktikës disiplinore, Komisionet Disiplinore gjykojnë me përbërje të plotë.

## **Neni 8**

### **Zgjedhja e komisioneve disiplinore dhe afati i qëndrimit në detyrë**

1. Anëtarët dhe Kryetari i Komisioneve Disiplinore Rajonale zgjidhen me votim nga Këshillat Rajonalë me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm për një periudhë 5 – vjeçare me të drejtë rizgjedhje. Në çdo rast, anëtarët dhe kryetari i Komisionit Disiplinor Rajonal nuk mund të zgjidhet nëse në mbledhje nuk janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të Këshillave Rajonalë.
2. Anëtarët dhe Kryetari i Komisionit Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar zgjidhen me votim nga Këshilli Kombëtar me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm për një periudhë 5 – vjeçare me të drejtë rizgjedhje. Në çdo rast, anëtarët dhe kryetari i Komisionit Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar nuk mund të zgjidhet nëse në mbledhje nuk janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të Këshillit Kombëtar.
3. Këshillat Rajonalë dhe Këshilli Kombëtar zgjedh edhe dy anëtarë zëvendësues, të cilët plotësojnë përbërjen e komisioneve kur krijohet vakancë, ose në rastet kur nga anëtarët e komisionit deklarohet konflikti i interesit.
4. Propozimet për anëtarë dhe kryetar të Komisioneve Disiplinore Rajonale mund të bëhen nga Presidenti i Këshillit Rajonal, ose të paktën tre anëtarë të Këshillit.

Propozimet për Kryetar dhe anëtarë të Komisionit Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar mund të bëhen nga Presidenti i Këshillit Kombëtar të USSH, ose të pakëtën 5 anëtarë të Këshillit Kombëtar.

### **Neni 9** **Kriteret për të kandiduar**

1. Për tu zgjedhur anëtar, apo Kryetar të Komisioneve Disiplinore, kandidati duhet të plotësojë në mënyrë komulative kriteret e mëposhtme.
  - a) Të jenë anëtarë të USSH për jo më pak se 5 vite.
  - b) Të kenë përvojë jo më pak se 5 vite në ushtrimin e profesionit (për stomatologët e përgjithshëm) dhe jo më pak se 3 vjet pune si stomatolog i specializuar.
  - c) Të kenë reputacion etiko - moral dhe kontribute në fushën e stomatologjisë.
  - d) Eksperienca në fushën administrative përbën kriter favorizues.
  - e) Të mos jenë ndëshkuar me masa disiplinore në 10 vitet e fundit.
  - f) Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për një veprë penale që ka lidhje me ushtrimin e profesionit të stomatologut, ose ndaj tyre mos të ketë filluar procedimi penal për vepra penale që kanë lidhje me ushtrimin e profesionit të stomatologut.
  - g) Të mos kenë funksione drejtuese në organe të tjera publike që kanë lidhje me fushën e mjekësisë, ose stomatologjisë.

### **Neni 10** **Lirimi nga detyra i Kryetarit dhe anëtarit të Komisionit Disiplinor**

1. Anëtarët dhe kryetarët e komisioneve disiplinore lirohen nga detyra përpara kohe në këto raste:
  - a) Paraqet dorëheqjen me shkrim.
  - b) Dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale që ka lidhje me ushtrimin e profesionit të stomatologut.
  - c) Rezulton se ka shpërdoruar detyrën si anëtar i komisionit, apo qëllimisht i shmanget pranisë në komisionin disiplinor për tre mbledhje radhazi.
  - d) Plotëson moshën e pensionit.
  - e) Për shkaqe fizike, apo shëndetësore është i paaftë për të ushtruar këtë detyrë.
  - f) Në raste të tjera, për të cilat vlerësohet se mandati i anëtarit, apo kryetarit të Komisionit Disiplinor nuk mund të vazhdojë.
2. Propozimet për lirimin përpara kohe të anëtarit, ose kryetarit të Komisioneve Disiplinore Rajonale mund të bëhen nga Presidenti i Këshillit Kombëtar të USSH, Presidenti i Këshillit Rajonal, ose të paktën tre anëtarë të Këshillit Rajonal. Propozimet për lirimin përpara kohe të anëtarit, ose kryetarit pranë Këshillit Kombëtar mund të bëhen nga Presidenti i Këshillit Kombëtar të USSH, ose të pakëtën 5 anëtarë të Këshillit Kombëtar.
3. Anëtari i Komisionit Disiplinor i larguar përpara kohe zëvendësohet nga një nga anëtarët zëvendësues, i cili zgjidhet me votim. Në këtë rast zbatohen dispozitat e nenit

8 të kësaj rregulloreje. Anëtari i zgjedhur rishtazi qëndron në detyrë deri në përfundim të mandatit të filluar për anëtarët e tjerë.

## **Neni 11**

### **Procedura paraprake dhe Gjykimi në Komisionin Disiplinor**

1. Ankesa/Kërkesa për fillimin e procedurës disiplinore paraqitet përpara Urdhrit Rajonal në të cilin stomatologu është anëtar. Kërkesa duhet të jetë në formë shkresore dhe duhet të tregojë në mënyrë të qartë identitetin e ankuesit, identitetin e stomatologut dhe/ose emrin e klinikës në të cilin është marrë trajtimi mjekësor, faktet dhe rrethanat e çështjes, të përcaktojë veprimin konkret, që pretendohet se përbën shkelje disiplinore dhe rrethanat e kryerjes së tij, provat në të cilin mbështeten pretendimet, si dhe çdo dokument apo provë tjetër në ndihmë të procedimit disiplinor. Kërkesa duhet të jetë e firmosur nga ankuesi/kërkuesi dhe i bashkëngjitet karta e identitetit të ankuesit.
2. Sekretari i Këshillit Rajonal regjistron ankesën në regjistrin e posaçëm që mbahet për këto raste dhe brenda 24 orëve i paraqet ankesën së bashku me dokumentacionin e treguar në pikën 1 të këtij neni Presidentit të Këshillit Rajonal. Presidenti i Këshillit Rajonal i asistuar nga juristi, vendos nëse plotësohen kushtet për pranimin e ankesës/kërkesës dhe kalimin e ankesës për shqyrtim në Komisionin Disiplinor. Kundër vendimit të Presidentit të Këshillit Rajonal për mospranimin e ankesës/kërkesës, mund të behet ankim në USSH brenda 15 ditëve nga dita që është njoftuar vendimi. Ankimi kundër këtij vendimi shqyrtohet nga njësia juridike në USSH, e cila njofton Kryetarin e Komisionit Rajonal dhe ankuesin për vendimin. Për vendimmarrjen njoftohet edhe Kryetari i Këshillit Rajonal.
3. Nëse ankesa plotëson kriteret për tu pranuar, Kryetari i Komisionit Disiplinor Rajonal nëpërmjet Sekretarit të Këshillit Rajonal njofton me email brenda 5 ditëve punë anëtarët e Komisionit Disiplinor Rajonal dhe cakton datën e mbledhjes së Komisionit.
4. Sekretari i Këshillit Rajonal njofton me email ose postë stomatologun, ose drejtuesin teknik kundër të cilit është bërë ankesa, si dhe ankuesin për datën dhe orën e mbledhjes.
5. Sekretari i Këshillit Rajonal dhe juristi janë përgjegjës për zbatimin e procedurës administrative. Procesverbali i mbledhjes mbahet nga sekretari i Këshillit Rajonal, ndërsa vendimi përfundimtar hartohet nga Komisioni Disiplinor me ndihmën e juristit.
6. Në ato raste kur për të njëjtën ankesë/çështje është paraqitur kallëzim penal pranë organeve kompetente, Komisioni Disiplinor pezullon procedurën deri sa për çështjen të jetë marrë vendim i formës së prerë nga këto organe. Gjykimi disiplinor pezullohet edhe kur për kallëzimin penal merret dijeni gjatë gjykimit të çështjes.
7. Në çdo rast kur Komisioni Disiplinor konstaton se ka elementë të kryerjes së një vepre penale, pezullon procedurën/gjykimin disiplinor dhe njofton menjëherë organin

kompetent për ushtrimin e ndjekjes penale, duke përcjellë fashikullin e gjykimit disiplinor me provat përkatëse.

### **Neni 12**

#### **Të drejtat dhe detyrimet e stomatologut kundër të cilit është bërë ankesa**

1. Sekretari i Këshillit Rajonal njofton stomatologun për ankesën e paraqitur duke i dërguar një kopje të ankesës së bashku me dokumentacionin shoqërues, si dhe të drejtën e tij për të paraqitur brenda 15 ditëve nga dita që janë njoftuar aktet qëndrimin e tij me shkrim, si dhe provat ku mbështet pretendimet e tij, ose prova të tjera që ai gjykon se janë të nevojshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes.
2. Stomatologu gëzon të gjitha të drejtat e parashikuara nga Kodi i Procedurës Administrative, duke përfshirë të drejtën për të qenë i pranishëm gjatë gjykimit disiplinor, ose përfaqësimit të tij me një përfaqësues ligjor/avokat të licencuar sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
3. Komisioni Disiplinor ka të drejtë të thërrasi stomatologun të jetë prezent gjatë gjykimit disiplinor kur kjo gjykohet e nevojshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes.

### **Neni 13**

#### **Të drejtat dhe detyrat e Komisionit Disiplinor**

1. Komisioni disiplinor heton të gjitha faktet dhe vlerëson të gjitha rrethanat e çështjes që janë të nevojshme për marrjen e vendimit, si dhe mund të përdorë çdo mjet për të mbledhur prova, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, e në veçanti, ai kryen veprimet e mëposhtme: a) shqyrton dokumentacionin dhe provat e paraqitura dhe verifikon faktet kundërshtuese;  
b) rishikon dokumentacionin përkatës për mospërputhje, për fakte që mungojnë, data apo firma që janë hequr etj;  
c) shqyrton dosjen e stomatologut;  
ç) thërret stomatologun për t'u njohur me variantin e tij të ngjarjeve;  
d) verifikon praktikat dhe rastet e procedimeve disiplinore të mëparshme (nëse ka);  
e) kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për verifikimin e ngjarjes.  
g) në çdo rast respekton parimin e një procesi të rregullt ligjor.

### **Neni 14**

#### **Njoftimi i palëve dhe seanca dëgjimore**

1. Seanca dëgjimore drejtohet nga Kryetari i kolegjit të caktuar me vendim të Kryetarit të Komisionit Disiplinor. Palët njoftohen në adresën që kanë vendosur në aktet që i dërgohen urdhrave përkatës dhe për stomatologët në adresën e shënuar në regjistrin kombëtar, ose në dosjen personale të hapur për licencimin e tyre. Njoftimi bëhet edhe në adresën ku stomatologu ushtron aktivitetin e tij, ose në mënyrë telefonike. Në këtë rast punonjësi i USSH mban procesverbal sipas legjislacionit në fuqi. Në seancën dëgjimore palët paraqiten vetë ose caktojnë një përfaqësues, sipas ligjit. Në rast se

- stomatologu apo përfaqësuesi i tij nuk paraqiten, edhe pse kanë marrë dijeni rregullisht, gjykimi disiplinor vazhdon në mungesë.
2. Komisioni Disiplinor shqyrton ligjshmërinë e veprimit/mjekimit që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit/mjekimit konkret.
  3. Si rregull, seanca dëgjimore zhvillohet vetëm në prani të palëve që janë pjesë e gjykimit disiplinor. Në raste të veçanta, kur e kërkon interesi publik, Komisioni Disiplinor mund të vendosi që seanca dëgjimore të zhvillohet në prani të personave të tretë përfshirë edhe median. Në këtë rast Komisioni Disiplinor vlerëson nëse cënohet dinjiteti i palëve në proces, ose të drejtat personale të tyre.
  4. Në fillim fjala i jepet palës që ka paraqitur ankimin, ose përfaqësuesit të saj për të paraqitur pretendimet e tij, si dhe nëse ka për të paraqitur prova të tjera përveç atyre që ka paraqitur me ankimin. Më pas fjala i jepet stomatologut, ose përfaqësuesit të tij ligjor për të paraqitur prapësimet e tij, si dhe prova të tjera përveç atyre që ka paraqitur më parë.
  5. Në raste të veçanta, ose kur i shërben rendit dhe mbarëvajtjes së seancës, Komisioni Disiplinor vendos që palët të pyeten veç e veç. Në çdo rast garantohet parimi i kontradiktorialitetit. Nëse ka nevojë për sqarime të mëtejshme, Komisioni mund të kërkojë që palët të japin sqarime të mëtejshme. Në çdo rast respektohen dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative. Nëse palët kërkojnë marrjen e provave të tjera, kërkesa vlerësohet nga Komisioni, i cili merr vendimin përkatës për pranueshmërinë ose jo të kërkesës. Në të gjitha rastet, shpenzimet për marrjen e provave të reja mbulohen nga pala që ka kërkuar provën.
  6. Pasi palët kanë paraqitur pretendimet përkatëse dhe nuk ka prova të tjera për tu paraqitur, palët ftohen për të paraqitur diskutimet përfundimtare. Në fazën e diskutimeve përfundimtare nuk mund të paraqiten prova të reja.
  7. Pasi palët kanë paraqitur, pretendimet përfundimtare, Komisioni Disiplinor tërhiqet për të marrë vendimin përkatës.

## **Neni 15**

### **Procesverbali i seancës**

1. Gjatë seancës dëgjimore, nga sekretari i Këshillit Rajonal mbahet procesverbali në formë të shkruar. Në procesverbal shënohet pjesmarrja e palëve dhe nëse është rasti pjesmarrja e personave të tretë. Sekretari i Këshillit Rajonal pasqyron në mënyrë të përmbledhur fjalën e palëve në procesin disiplinor që zhvillohet. Nëse janë mundësitë, seanca dëgjimore mund të regjistrohet me audio dhe video, të cilat i bashkëngjiten me disk procesverbalit të shkruar.
2. Në asnjë rast dokumentacioni i depozituar në dosje nuk mund të bëhet publik pa miratimin e Kryetarit të Komisionit Disiplinor dhe Presidentit të urdhrorit rajonal. Në çdo rast respektohen dispozitat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
3. Në përfundim të gjykimit disiplinor, procesverbali firmoset nga anëtarët e Komisionit Disiplinor, juristi dhe sekretari i Këshillit Rajonal.

## **Neni 16**

### **Vendimarrja në dhomë këshillimi**

1. Komisioni Disiplinor shqyrton ligjshmërinë e veprimit/mjekimit që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura në seancë dëgjimore nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit/mjekimit konkret.
2. Kryetari i kolegjit i kërkon anëtarëve të Komisionit Disiplinor të shprehin mendimin e tyre nëse ndaj stomatologut duhet të merret ose jo masë disiplinore. Anëtari më i ri në moshë shpreh mendimin e pari dhe më pas merret mendimi i anëtarëve të tjerë sipas kriterit të moshës. Në përfundim, Kryetari i kolegjit hedh në votim nëse ndaj stomatologut duhet të merret masë disiplinore ose jo. Anëtarëve të komisionit disiplinor nuk i lejohej të abstenojnë.
3. Vendimi merret me shumicën e votave të anëtarëve të Komisionit Disiplinor dhe për të garantuar parimin e paanshmërisë nuk mund të shtyhet për një ditë tjetër.
4. Vendimi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit Disiplinor. Anëtarët që kanë votuar kundër nënshkruajnë vendimin duke bërë edhe shënimin përkatës. Në çdo rast mendimi kundër duhet të arsyetohet.
5. Vendimi i zbardhur depozitohet në sekretarinë e urdhrin dhe regjistrohet në regjistrin e posaçëm që mbahet për procedimet disiplinore.
6. Vendimi i njoftohet palëve sipas parimeve të Kodit të Procedurës Administrative, të cilat kanë të drejtën e ankimit brenda afateve ligjore.

### **Neni 17** **Përmbajtja e vendimit**

1. Vendimi i Komisionit Disiplinor përmban:
  - a) pjesën hyrëse, që përmban:
    - i) emrin e organit publik që nxjerr vendimin;
    - ii) palët të cilave u drejtohet vendimi;
    - iii) datën e miratimit;
    - iv) bazën ligjore;
  - b) pjesën arsyetuese;
  - c) dispozitivin që tregon:
    - i) pjesën urdhëruese që tregon çfarë është vendosur;
    - ii) kohën e hyrjes në fuqi të vendimit;
    - iii) të drejtën e ankimit, përfshirë organin ku mund të paraqitet ankimi, dhe afatin për paraqitjen e ankimit.

### **Neni 18** **Tërheqja e kërkesës, apo braktisja e procedurës**

1. Si rregull, në procedurën disiplinore të nisur me kërkesë, Komisioni Disiplinor deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.
2. Komisioni Disiplinor mund të deklarojë përfundimin e procedurës së nisur me kërkesë, pa vendim përfundimtar edhe nëse rezulton qartazi nga rrethanat se pala që ka paraqitur kërkesën, nuk ka më interes për vazhdimin e procedurës dhe e ka braktisur atë (nuk paraqitet në seancën dëgjimore edhe pse ka njoftim në mënyrë të rregullt).
3. Në çdo rast, tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës nuk ndikon në vazhdimin e saj, nëse Komisioni Disiplinor çmon se vazhdimi i procedurës është në interes

- publik, me përjashtim të rasteve kur procedura është e tillë që mund të vazhdojë vetëm me praninë e palës që ka paraqitur ankim.
4. Procedura deklarohet e braktisur pa një vendim përfundimtar për çështjen, në qoftë se pala e interesuar, për fajin e saj, ka qenë pasive gjatë afatit për përfundimin e procedurës disiplinore.
  5. Nëse pala, person fizik, vdes gjatë zhvillimit të procedurës administrative që zhvillohet për një çështje të karakterit personal, organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative, pa marrë një vendim përfundimtar për çështjen. Në çdo rast tjetër, nëse organi publik vlerëson nëse pjesëmarrja e palës është e domosdoshme, pezullon procedurën përkohësisht deri në identifikimin e trashëgimtarëve.
  6. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, edhe në rastin e mbarimit të personit juridik, kur ky i fundit është palë, Komisioni Disiplinor deklaron përfundimin e procedurës administrative pa marrë një vendim përfundimtar.

### **Neni 19**

#### **Llojet e masave disiplinore**

1. Kur vërtetohet se stomatologu, anëtar i Urdhrit të Stomatologëve të Shqipërisë ka kryer shkelje sipas dispozitave të kësaj rregulloreje lidhur me ushtrimin e profesionit ndaj tij mund të jepen një ose më shumë nga masat e mëposhtme:
  - a) Vërejtje me shkrim.
  - b) Vërejtje me paralajmërim për tu përjashtuar nga Urdhri i Stomatologut të Shqipërisë.
  - c) Gjobë nga 15.000 deri në 100.000 mijë lekë.
  - d) Propozim për shkarkim nga funksione drejtuese në institucione shëndetësore publike, ose private.
  - e) Pezullim nga e drejta e zgjedhjes në organet drejtuese të Urdhrit të Stomatologut të Shqipërisë për një periudhë deri në tre vjet.
  - f) Përjashtim nga Urdhri i Stomatologut të Shqipërisë për një periudhë deri në tre vjet.
2. Masa disiplinore e parashikuar në shkronjën “f” të pikës 1 të këtij neni sjell si pasojë heqjen e së drejtës së ushtrimit të profesionit për afatin e caktuar në vendimin e Komisionit Disiplinor.
3. Përveç masave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, Komisioni Disiplinor ka të drejtë ti caktojë stomatologut, si masë plotësuese edhe kryerjen e një rikualifikimi, ose studimeve plotësuese të barabarta me 20 kredite, përveç krediteve që duhet të marri normalisht.
4. Në caktimin e masave disiplinore, Komisioni Disiplinor merr parasysh:
  - a) Rrethanat e kryerjes së shkeljes.
  - b) Nëse ndaj stomatologut janë marrë më parë masa disiplinore.
  - c) Rëndësinë e shkeljes së bërë.
  - d) Pasojat që i kanë ardhur pacientit nga veprimi/mosveprimi, apo mjekimi i stomatologut.

### **KREU III**

#### **GJYKIMI NË KOMISIONIN DISIPLINOR PRANË KËSHILLIT KOMBËTAR**

### **Neni 20**

#### **Ankimi dhe përmbajtja e tij**

1. Ankimi kundër vendimit të Komisionit Disiplinor Rajonal paraqitet në Komisionin Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr. 127/2014 “Për Urdhrin e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë”. Afati i ankimit fillon nga dita që vendimi i është njoftuar palëve.
2. Ankimi si rregull paraqitet në Sekretarinë e Komisionit Disiplinor Rajonal që ka marrë vendimin, e cila e dërgon atë në USSH brenda 5 ditëve pune së bashku me fashikullin e gjykitimit disiplinor dhe të gjithë dokumentacionin që ka shërbyer për marrjen e vendimit. Në ato raste kur ankimi paraqitet drejtpërdrejtë në USSH, sekretaria i kërkon urdhrin rajonal të dërgojë brenda 5 ditëve pune fashikullin e gjykitimit disiplinor.
3. Ankimi depozitohet në formë shkresore dhe duhet të përmbajë:
  - a) Palët në procedurën disiplinore.
  - b) Vendimi kundër të cilit bëhet ankimi.
  - c) Shkaqet për të cilat bëhet ankimi.
  - d) Çfarë kërkohet me ankimin.
4. Bashkë me ankimin duhet të paraqiten:
  - a) Prokura, kur ankimi paraqitet nga avokati, ose përfaqësuesi i palës.
  - b) Pagesa për shqyrtimin e ankimit në Komisionin Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar.
5. Në rast se ankimi nuk plotëson kushtet si më sipër, Sekretari i Përgjithshëm i USSH njofton palët për ndreqjen e të metave brenda 5 ditëve pune. Nëse të metat nuk rregullohen brenda këtij afati, ankimi kthehet dhe vendoset në përfundim mospranimi i tij.
6. Në raste kur ankimi përmban të gjithë elementët e cituar në pikën 3 dhe 4 të këtij neni, ai regjistrohet në regjistrin e posaçëm për gjykitimet disiplinore në USSH.

## **Neni 20**

### **Gjykimi disiplinor në Komisionin Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar të USSH**

1. Për zhvillimin e gjykitimit disiplinor në Komisionin Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar të USSH zbatohen të njëjtat rregulla të përcaktuara për gjykitimin disiplinor në shkallë të parë.
2. Si rregull në këtë fazë të gjykitimit nuk lejohet paraqitja e provave të reja me përjashtim të rasteve kur provat janë zbuluar pasi ka përfunduar gjykimi disiplinor në shkallë të parë, ose kur kjo çmohet e nevojshme nga shumica e anëtarëve të Komisionit Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar.
3. Në përfundim të gjykitimit, Komisioni Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar në USSH vendos:
  - a) Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit Disiplinor Rajonal.
  - b) Ndryshimin e vendimit të Komisionit Disiplinor Rajonal, duke gjykuar në themel çështjen.
  - c) Prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes kur plotësohen kushtet e parashikuara në nenin 18 të kësaj rregulloreje.
4. Kundër vendimit të Komisionit Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda afateve të parashikuara nga legjislati i fuqi.

## **Neni 21**

### **Shlyerja e masave disiplinore**

1. Masat disiplinore të parashikuara në pikën 1, shkronjat “a” dhe “b” të nenit 19 të kësaj rregulleje konsiderohen të shlyera pasi ka kaluar një vit nga dhënia e tyre, nëse ndaj stomatologut gjatë kësaj kohe nuk është marrë masë tjetër.
2. Masat disiplinore të parashikuara në pikën 1, shkronjat “d”, “e” dhe “f” të nenit 19 të kësaj rregulleje konsiderohen të shlyera pasi kanë kaluar dy vite nga dhënia e tyre, nëse ndaj stomatologut gjatë kësaj kohe nuk është marrë masë tjetër.
3. Në raste të veçanta, kur ekzistojnë shkaqe të bazuara, Presidenti i Këshillit Kombëtar të USSH ka të drejtën e faljes për stomatologun, ose drejtuesin teknik ndaj të cilit është marrë masë disiplinore. Me aktin e faljes Presidenti i Këshillit Kombëtar përjashton tërësisht apo pjesërisht personin nga dënimi me masë disiplinore të dhënë me një vendim komisionit Disiplinor Rajonal dhe/ose të Komisionit Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar, ose bën zëvendësimin e masës së dhënë me një lloj mase më të butë.

## **Neni 22**

### **Shpërblimi për marrjen pjesë në komision dhe tarifat e gjykimit**

1. Anëtarët e komisioneve disiplinore, ekspertët dhe juristi shpërblehen nga USSH me honorare sipas tarifave të përcaktuara nga Këshilli Kombëtar i USSH.
2. Kur mbledhjet zhvillohen jashtë rrethit, ose thirren nga organet e USSH, ata përfitojnë shpenzimet e udhëtimit dhe dietë ditore sipas tarifave të përcaktuara nga Këshilli Kombëtar.
3. Shpenzimet për procedurën disiplinore parapagohen nga pala që bën ankimin dhe në përfundim të gjykimit në çdo shkallë nga pala humbëse. Pagesa për gjykimin disiplinor në urdhrat rajonale është 30.000 (tridhjetë mijë) lekë. Pagesa për shqyrtimin e ankimit në Komisionin Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar është 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë. Pagesa për gjykimin disiplinor për rastet e reklamave është 100.000 mijë lekë për çdo shkallë gjykimi.
4. Përpara se të fillojë gjykimi disiplinor, në shkallë të dytë Komisioni Disiplinor pranë Këshillit Kombëtar verifikon kryerjen e pagesës së tarifës të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni. Në çdo rast gjykimi në shkallë të dytë nuk mund të fillojë nëse nuk janë bërë pagesat e tarifave të përcaktuara.
5. Në rastet kur tarifat nuk paguhen në afatet e përcaktuara, i shtohen kamatat ligjore sipas legjislacionit në fuqi.

## **Neni 23**

### **Dispozitë tranzitore**

1. Për ankimet e paraqitura përpara datës së hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, zbatohen dispozitat e rregullores që ka qenë në fuqi në kohën e paraqitjes së ankesës.

## **Neni 24**

### **Hyrja në fuqi**

1. Rregullorja dhe çdo akt tjetër që ka të bëjë me gjykimin disiplinor që kanë qenë fuqi deri në momentin e miratimit të kësaj rregulloreje, shfuqizohen.
2. Kjo rregullore publikohet në faqen zyrtare të USSH.

3. Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit të saj.

**Miratuar në mbledhjen e Këshillit Kombëtar datë 19.12.2025.**